

Të Ndjekësh Udhëheqësin

Fleta e Mësuesit

Vlerat

Vet-motivimi, Bashkëpunimi, Përlësia, Sakrifica, Këmbëngulja

Qëllimet

Pedagogjike: Zhvillimi i përlësisë dhe këmbënguljes përmes zbatimit të detyrave kur ka disa pengesa.

Praktike: Kryerja e një vizatimi, në grup, ku secili nxënës paraqitet si invalid.

Pjesëmarrësit

Minimumi: 10 pjesëmarrës
Maksimumi: 30 pjesëmarrës

Kohëzgjatja

15 deri 30 minuta

Materialet

Letër dhe stilolaps
Shirita për të lidhur duart dhe mbuluar sytë

Përmbledhje

Klasa ndahet në grupe me 5 nxënës secili. Secilit grup i kërkohet të vizatojë një varkë duke përdorur një letër dhe lapsa me ngjyra.

Çdo nxënës vizaton nga një vijë secili duke ia kaluar vizatimin nxënësit tjetër. Për shembull: nxënësi i parë bën një vijë, ndalon, dhe ia kalon vizatimin nxënësit tjetër.

Procedura përsëritet duke siguruar që secili nxënës i grupit të vizatojë një vijë derisa vizatimi të mbarojë plotësisht.


Nxënësit duhet të ndjekin gjithashtu karakteristikat individuale si më poshtë:

Pjesëmarrësi 1 – është i verbër dhe ka vetëm krahun e djathtë;
Pjesëmarrësi 2 – është i verbër dhe ka vetëm krahun e majtë;
Pjesëmarrësi 3 – është i verbër dhe shurdh;
Pjesëmarrësi 4 – është i verbër dhe memec;
Pjesëmarrësi 5 – nuk ka krahë.

Në këtë mënyrë për të realizuar këto role, mësuesi/ja pyet grupet se kush do të zgjedhë të jetë numri 1, 2, 3, 4, 5 dhe pastaj u shpërndan copën për të lidhur sytë dhe dorën që nuk duhet të përdorin gjatë aktivitetit.

Në momentin që grupet janë gati, fillon të llogaritet koha duke lejuar grupet të interpretojnë detyrën pa i ndërprerë.

Gjatë kësaj kohe, mësuesi/ja qëndron i heshtur, vetëm duke vëzhguar zhvillimin e aktivitetit. Nëse dikush kërkon ndihmë ose informacion, përsëriten instruksionet e dhëna në fillim pa i dhënë ndonjë orientim tjetër.



Të Ndjekësh Udhëheqësin

Fleta e mësuesit (vazhdimi)

Shënime

Në rast se ndonjë nga pjesëmarrësit bën pyetje të tilla si p.sh. “Është e saktë = Mund të bëhet në këtë mënyrë?”, pyetja duhet t’i drejtohet përsëri grupit, duke e lënë atë që të vendosi vetë. Këto situata mund të përmbliidhen në diskutim, për analizë dhe si ilustrim për komente të tjera.

Për mbështetje dokumentuee, ju lutem vizitoni:

<http://www.euroblind.org/> & <https://www.shvsh.org.al>

Diskutimi

Çfarë vështirësish ndjetë ndërkohë që po vizatonit?

Si do ta klasifikonit performancën tuaj si grup?

Gjatë aktivitetit, cili prej jush mori rolin e drejtuesit?

Personat invalid e ndjenë që e realizuan mirë detyrën?

U ndjetë inferior? Pse?

Pengesat që kaluat gjatë aktivitetit ju kanë ndodhin edhe gjatë jetës?
Mund të jepni shembuj?

Çfarë mund të lehtësonte realizmin e rolit tënd? Çfarë mund dhe duhet të përmirësohet herën tjetër kur të zhvillohet aktiviteti?

Çfarë mësimi nxorret që mund t’ju ndihmojë se si të silleni në të ardhmen në lidhje me njerëzit invalid.

*Të nxiten përpjekjet për identifikimin e argumenteve të tjera nga nxënësit në lidhje me personat invalid.

